



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 16.2.2015, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Shaip Muja.

Mungoi : Salih Salihu, Velimir Rakiq, Murat Hoxha.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 10.2.2015,
3. Shqyrtimi i nismës legislative të Komisionit për hartimin e Projektligjit për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Ujrave të Ndotura dhe të Furnizuesve të Ujit me shumicë,

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.2.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3.Shqyrtimi i nismës legislative të Komisionit për hartimin e Projektligjit për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Ujrave të Ndotura dhe të Furnizuesve të Ujit me shumicë

Kryetari në fillim falënderoi për pjesëmarrjen e të ftuarve dhe sqaroi shkurtimisht gjendjen aktuale rreth këtij ligji përkatësisht nismës për këtë ligj që nga legjislacioni i kaluar, kur nuk ka arrit të përfundoj procedimi, propozoi dy variante për mënyrën e shqyrtimit të sotëm me mysafir të ftuar, shqyrtimi nën për nën ose dëgjimi i mendimeve nga të pranishmit. Pasi që komisioni sugjeroi dëgjimin, fillimisht, të mendimeve të të ftuarve, fjalën e mori **Gjelosh Vataj** –drejtor i ujësjetës Prishtina, i cili kishte dy vërejtje në draftin e komisionit, e para tek Neni 1.14 pika 2 rreth taksave për çka sugjeroi përqindjen në inkasim të jetë 1% në mënyrë që të ndihmohen konsumatorët, dhe e dyta tek Neni 29 ku sugjeroi të hiqet pika 3 ngase nuk ka nevojë të potencohet orari i punës. I ceku edhe disa gjëra dhe potencoi se ujësjetësi i Prishtinës me 80% të inkasimit çdo vit po përmirësohet më shumë, dhe theksoi se çështjet sociale nuk duhet të hyjnë në ligj ngase Qeveria është ai që mendon për ato. **Raif Preteni** – drejtor i zyrës, arsyetoi qëndrimin e cila është shkruar në draft, përkatësisht inkasimin në shkallë 1,5 % për shkak se zyrja rregullatore financimin e bënë me mjete vetanake, që do të thotë se inkasimi apo faturimi duhet ti përshtatet buxhetit, nëse jo atëherë ju njoftoi se buxheti i zyrës është i vogël, përfundoi. **Shaip Muja** falënderoi për bashkëpunimin dhe potencoi faktin se ai nuk është mjaft i familjarizuar me këtë çështje për shkak të informimit të jokompletuar, sidomos me rregulloren e UNMIK-ut, por në kuadër të diskutimeve ai tha se është i mendimit që ligji nuk duhet të potencoi përqindjen ngase “gjithkush e din që dikah vinë paret” dhe që buxheti i Kosovës nuk është diçka më lartë por e njëjta gjë. Lidhur me termet privat dhe publik pyeti pse të ceken në ligj dhe kush janë këta furnizues, uji është aset publik, ndërkaq i panevojshëm është pika 3 i Nenit 29 dhe është i paqartë rreth shkyçjeve gjatë vikendit etj. Ai sugjeroi që këto çështje (ujërat e ndotura, drejtori të ketë integritet të lart moral, lidhjet familjare, martesore, mosshfrytëzimin e sistemit të ramjes së lirë) mos të shqyrtohen me nguti, dhe të shikohen fillimisht ngase ka elemente të komunizmit etj, kërkoi edhe organogramin nga zyrja rregullatorë, të sqarohet çështja e heqjes së zëvendës-drejtorit. **Lahi Brahimaj** u fokusua në çështje të gabimeve që bëhen me fatura, ndërsa z. Vataj u përgjigj, mirëpo **Kryetari** i luti të pranishmit të fokusohen në ligj. **Emilija Redzeqi** mbështeti diskutimet dhe vërejtjet sidomos rreth termeve privat-publik, çështje sociale (ngase të gjithë jemi të barabartë lidhur me ujë) por mbështeti edhe faktin se ligji është i mirë dhe potencoi se do të ishte mirë që vërejtjet të shqyrtohen pas leximit të parë. **Baton Begolli**, e para, sqaroi se ky ligj mbron konsumatorin dhe standardet e shërbimit, nuk trajton ndërmarrjet publike, ligjet e deritanishme për ujëra duhet të shikohen në aspektin e politikës së suksesit e jo të bazohen në dështime, lidhur me taksën 1,5 tha se duhet të jetë në faturim e jo në inkasim dhe për ngritje të faturimit, nuk është e drejtë që gjithë problemi i sektorit të ujërave të reduktohet tek pjesa e rasteve sociale dhe të përdoret kjo kategori për të arsyetuar kërkesat, ndaj duhet që ujësjetësit të fusin në përdorim edhe ligjet tjera si p.sh. për detyrime dhe ai për përmbarim. Rregullatori nuk duhet trajtuar si diçka e imponuar nga UNMIK-ut ngase aty kemi pas vendor të cilët kan kontribuar, ndërsa të huajt vinin e shkonin, dhe mund të ju njoftoi se jemi më të avancuarit në rajon e më gjerë në këtë drejtim, sa i përket qeverisjes së ujërave dhe Rregullatorit që kemi, përfundoi, dhe e dyta, edhe pse çështja e ujit është çështje publike (ka pasur mjaft presione për ta privatizuar), ndonjëherë do të obligohemi të përfshijmë ndihmën nga kompanitë private të cilat duhet të licencohen për një eks detyrë p.sh. për ujë të pafaturuar si tha ai për të mbledhur ajkën e zahireve (potencoi kompaninë ZAHIRI dhe TOIFOR). Ndërhyri **Shaip Muja** dhe tha : unë e pata për ujin, ti po flet për shërbime, vazhdoi **Baton Begolli** : furnizimi me ujë menaxhohet nga ujësjetësi mbi 80 %, ndërsa ajo që mbetet në disa raste, do të ketë nevojë të gjejmë mënyra alternative të ofrimit të shërbimeve por gjithnjë nën petkun e ujësjetësit rajonal. **Faton Frangu** Ferizaj, potencoi bashkëpunimin e mirë dhe kërkoi që TVSH të deklarohet në inkasim ngase shkyqjet nuk bëhen vetëm për borxhe, por ka edhe keqpërdorime të ndryshme. **Adem Salihaj** falënderoj për bashkëpunim dhe potencoi se ky bashkëbisedim ishte mjaft e dobishme për komisionin, sugjeroi të njoftohet komisioni për disa cifra p.sh. sa janë

mjetet e rregullatorit dhe a është e arsyeshme 1,5%-shi, a duhet nga faturimi apo nga inkasimi, pasi të shihen këto fakte të veprohet me një ose 1,5%, ngase më mirë do të ishte mos të ngarkohet buxheti, gjithashtu ky ligj-draft nuk përfshinë cilësinë e shërbimeve që duhet të ofrohen nga kompanitë e ujit, gjëra këto që krijojnë mjegullira por janë esenciale, p.sh. ka fshatra që kërkojnë hyrjen në sistemin e ujësjellësit por të cilat i kanë ndërtuar vet ngase uji është aset publik, krejt kjo që mos të krijohen laramani për furnizues të ujit, ai shtroi edhe disa pyetje të hapura që kërkojnë zgjidhje rreth shërbimeve, kompanive, përmirësime teknike dhe gjuhësore të draftit, mendimin e këshillave të konsumatorëve etj. **Raif Preteni** përsëriti disa qëndrime rreth arsytimit të taksës si qëndron në draft, ndërsa rreth kërkesës për organogramin tha se ai qëndron ashtu që disa kohë e pandryshuar, kurse kërkesën për ekzistimin e zëvendës drejtorit në rregullatorë e arsyetoi ngase kjo zyre nuk ka bord. Edhe pse Ligji për ndërmarrjet publike ka shtuar privatizimin, ai mendoi se kjo është larg në rastin tonë, ngase është vështirë e realizueshme (ky ishte sqarimi i tij rreth fjalës privat në draftin ekzistues). Rreth ujërave të zeza theksoi se duhet të caktohet tarifa e impianteve, kurse për cilësi të ujit tha se kompetente është MSH përkatësisht IKSHK e cila pasi që publikon rezultatet, ato dërgohen kompanive për përmirësimin e cilësisë së ujit. **Emilija Redzeqi** përsëriti faktin e cekur nga mbledhjet e kaluara se rajoni i Zhupës nuk gjendet në sistemin e ujësjellësit dhe përpjekjet e saja si politikë në këtë drejtim dmth 10.000 banorë të kësaj ane nuk përfshihen në sistemin unik (prej Prevallës deri te Drini) dhe pyeti pse nuk ka strategji për të futur këtë rajon gjeografik në regjistrin e pagesave për të unifikuar. **Gjelosh Vataj** theksoi se vetëm ujësjellësi i Prishtinës punon pa humbje kurse ndërhyrja e deputetes Redzeqi ka të bëjë me konsumatorë të cilët janë të barabartë para ligjit, pa potencuar nacionalitetin. Investime të reja, vazhdoi, do të kemi nëse inkasimet shtohen, lidhur me cilësi tha se dëshmitë-raportet e kënaqshmërisë nga organizatat botërore tregojnë se cilësia e ujit është e kënaqshme dhe asnjëherë nuk ka pasur vërejtje-mostra të cilat tejkalojnë 1%-shin. **Baton Begolli** sqaroi, poqes kërkohej apo insistohet të merren të holla edhe nga qeveria për këtë zyre, atëherë ku mbetet pavarësia e ZRRUK me çka ne mburemi në rajon se jemi më të pavarur se të gjitha tjerat në rajon. **Shaip Muja** pyeti Drejtorin e ZRRUK çka nëse ju teprojnë ndonjëherë të hollat dhe a është kjo pavarësi relative, ngase dihet që dikah vinë paret, shtoi, problemi është që të krijohet optimumi i funksionimit, pra të hiqet nga ligji përqindja sepse Kuvendi autorizon por jo të caktoj përqindje. **Adem Salihaj** vazhdoi me këtë fokusim dhe pyeti sa duhet të jetë përqindja dhe mendoi se nuk mund të janë barabartë dikush që paguan 58% e dikush 100 %, arsyetoi përqindjen nga inkasimi e jo nga faturimi, formula sipas tij është : këta paguajnë buxhetit, kurse kuvendi cakton shumën e sakt. **Lahi Brahimaj** : vështirë është të punohet “me tahmin”. **Faton Frangu** : po kuptojë mirë por çka të bëjmë kur ligji po lejon këtë mundësi që po e len mundësinë me marr pak prej buxhetit. **Shaip Muja** : kam ende vërejtje (perspektiva e kompanive, aplikimet, matëset ujqorë, kalibrimet, bazhdarimet etj) të cilat nuk i thash këtu, shtoi.

Kryetari Fikrim Damka falënderoi dhe përmbledhi diskutimet e sotme në :

1. Dy vërejtje për dy nene,
2. Ekzistimin e zëvendës drejtorit apo bordit dhe
3. Të tjera,

ndaj propozoi takimin më 23 shkurt kur komisioni në cilësinë e grupit punues prapë do të mundohet të finalizoi draftin , **i cili draft do të konsiderohet nismë nga ky komision.**

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka